



NEW HORIZON
Civil Society Organization

Fëmijët

në konflikt me ligjin

UDHËZUES I SHKURTËR



Fëmijët në konflikt me ligjin

Udhëzues i shkurtër

Botimin e këtij publikimi e mbështeti Ambasada e SHBA në Podgoricë, përmes **Byrosë për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL)**.

Titulli i projektit:

PARTNERITETI LOKAL KUNDËR ABUZIMIT TË DROGAVE DHE DELIKUENCËS SË TË MITURVE

Realizues:

OJQ Horizonti i Ri - Ulqin

Partnerë në projekt:

KOMUNA E ULQINIT (Zyra për Parandalimin e Narkomanisë)

GJYKATA THEMELORE – Ulqin

PROKURORIA E SHETIT – Ulqin

ZYRA E POLICISË – Ulqin

QENDRA PËR PUNË SOCIALE – Ulqin

SHTËPIA E SHËNDETIT - Ulqin

Projekti realizohet në kuadër të Programit të mbështetjes së shoqërisë civile në fushën e drejtësisë penale

(2015-2016 CRIMINAL JUSTICE CIVIL SOCIETY PROGRAM - CJCSF)

Përmbajtja e këtij udhëzuesi është përgjegjësi vetëm e OJQ Horizonti i Ri dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet qëndrimin e Ambasadës Amerikane, respektivisht Byrosë për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit (INL)

FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Botues:

OJQ "Horizonti i Ri" - Ulqin

E-mail: horizon@t-com.me

www.ngo-horizonti.org

Për botuesin:

Nazif Veliqi

Ekipi realizues:

Ilirjana Boci – punonjëse sociale

Mehmet Duraku – sociolog

Arben Hoxhiq – jurist

Renata Blenishta – politikologe

Ardita Kovaçeviq - psikologe

Dizajni dhe përgatitja teknike:

Arben Husiq

Shtypi:

TRIO PRO Ulqin

Ulqin, maj 2016

KUJT I SHËRBEN KY UDHËZUES?

Ky udhëzues iu kushtohet të gjithë fëmijëve/të rinjve të mitur, prindërve të tyre, kujdestarëve, mësime dhënëse, por edhe publikut të gjërë.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është informimi i fëmijëve që vijnë në kundërshtim me ligjin për të drejtat e tyre. Shprehja "Fëmijët në konflikt me ligjin" i referohet të gjithë fëmijëve nën 18 vjeç që vijnë në kontakt me sistemin e drejtësisë, si pasojë e akuzimit apo dyshimit për kryerjen e një veprë penale.

Informimi si masë parandaluese do t'i ndihmojë fëmijët të kuptojnë përgjegjësitë e tyre ndaj ligjit dhe do t'i ndihmojë në shmangien e konfliktit. Me anë të informimit dhe njohurive mbi të drejtat e tyre që iu takojnë, fëmijët do të rriten e do të formohen në persona të përgjegjshëm dhe në këtë mënyrë do të respektojnë edhe të drejtat e të tjerëve.

Udhëzuesi "**Fëmijët në konflikt me ligjin**" ka për qëllim që të miturit t'i njohë me të drejtat e tyre, duke i informuar ata për:

- *Rolin dhe punën e Qendrës për Punë Sociale në raport me fëmijët,*
- *Punën e Policisë - mënyrën si duhet të silltet Policia me ata dhe të drejtat e tyre në qoftë se bien në kontakt me Policinë,*
- *Procedurat ligjore ndaj të miturve në konflikt me ligjin,*
- *Ndëshkimet ndaj fëmijëve në qoftë se shkelin ligjin.*

Ky publikim është pjesë e projektit të gjerë me titull "PARTNERITETI LOKAL KUNDËR ABUZIMIT TË DROGAVE DHE DELIKUENCËS SË TË MITURVE".

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është ngritja e vetëdijes së të rinjve për efektet e dëmshme të abuzimit me droga si dhe ulja e shkallës së sjelljeve antisociale dhe delikuede në mesin e të rinjve në komunën e Ulqinit.

FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Delikuenca e të miturve është dukuri psikike e cila manifestohet me mosrespektimin e normave morale dhe juridike. Ajo gjithmonë ka ekzistuar dhe është shfaqur ku më pak e ku më shumë, varësisht nga ndryshimet në shoqëri dhe në mjedisin ku kanë jetuar të rinjtë. Delikuenca është një lloj sjelljeje në kundërshtim me normat e caktuara shoqërore.

Delikuent quhet individi i cili me veprimet e veta jo vetëm që shkel normat e mjedisit, por edhe cenon të drejtat dhe liritë e tjetrit dhe bie direkt në konflikt me të tjerët.

Delikuenca e të rinjve nuk paraqitet befas dhe papritur, por ka një fazë parapërgatitore, që fillon me sjellje antisociale nga mosha e pubertetit. Dihet se rritja është një proces shumë dinamik, periudha më intensive në jetën e njeriut, e cila karakterizohet me ndryshime të shumta emocionale, me përvetësimin e njohurive dhe adoptimin e zakoneve të ndryshme, qëndrimeve, gjykimeve dhe vlerave. Këto ndryshime asnjë fëmijë nuk i përjeton në të njëjtën mënyrë. Disa arrijnë t'i menaxhojnë si duhet, kurse disa nuk janë të aftë t'i përballojnë dhe shpesh kjo shërben si shkak i sjelljeve antisociale të tyre. Sjelljet antisociale të fëmijëve në këtë moshë janë të shumta dhe të ndryshme. Ato shfaqen në një gamë të gjerë si kryeneçësi, fyerje dhe sharje, rrahje, mosbindje dhe mosdurim, vjedhje, ikje nga shtëpia e nga shkolla, etj.

Në qoftë se në këtë moshë nuk merren masa të duhura për mënjanimin e tyre, ato dalëngadalë rriten e shumohen dhe bëhen potencial optimal për delikuenca të vërtetë.

Kërkimet bëjnë të qartë se mbyllja e fëmijëve në institucione është një proces shumë i dhimbshëm për çdo fëmijë; ajo dëmton zhvillimin e fëmijës dhe jep efektin e kundërt në socializmin e tij. Gjithashtu, në përgjithësi, është pranuar që mohimi i lirisë rrallëherë është një masë efektive për sa i përket rehabilitimit, riintegritit dhe parandalimit të shkeljeve të mëtejshme.



I mituri dallon nga i rrituri në rastin e kryerjes së veprës penale. Për këtë fëmijët në konflikt me ligjin duhet të trajtohen ndryshe nga delikuentët e rritur.

Të drejtat e fëmijëve janë të përcaktuara nga Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila u miratua në vitin 1989, si traktati i parë ndërkombëtar që merret me mbrojtjen e plotë të të drejtave të fëmijëve. Konventa është një udhëzues se si fëmijët duhet të trajtohen dhe të mbrohen.

Një organ i posaçëm ndërkombëtar i Komitetit të OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës monitoron zbatimin e Konventës në shtetet që e kanë ratifikuar atë.



Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës është pjesë e sistemit të brendshëm juridik të shtetit tonë dhe krahas ligjeve të brendshme, së bashku me instrumentet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara, ka përparësi ndaj legjislacionit kombëtar të Malit të Zi.

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve është për të gjithë ata që punojnë me fëmijët, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes angazhimit profesional vijnë në kontakt me fëmijët: *prindërit, mësuesit, edukatorët, zyrtarë të lartë të shtetit, punonjës të kujdesit shëndetësor dhe punonjës social, juristë, gjyqtarë, oficerë të policisë.*

Konventa iu dedikohet edhe fëmijëve. Fëmijët kanë nevojë të dinë të drejtat e tyre që iu takojnë nga lindja. Nëse janë të përkushtuar për respektimin e të drejtave të tyre, fëmijët zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë për respektimin e të drejtave të të tjerëve. Kur marrin pjesë në vendimmarrje, mësojnë të marrin përgjegjësi për realizimin e tyre. Duke njohur dhe duke u angazhuar për të drejtat e tyre, fëmijët arrijnë të vetëdijësohen se këto të drejta iu takojnë edhe të tjerëve.



Parimet kryesore të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës janë: respektimi i interesit më të mirë të fëmijës, e drejta e fëmijës për jetë, mbijetesë dhe zhvillim, jo-diskriminimi si dhe pjesëmarrja aktive e fëmijës në të gjitha procedurat në lidhje me të.

Në përputhje me këto parime, një fëmijë në konflikt me ligjin duhet të gëzojë respekt të plotë të të drejtave të njeriut të garantuara me kushtetutë, ligj dhe rregulloret e aplikueshme ndërkombëtare, si të gjithë fëmijët nën juridiksionin e shtetit përkatës.

Ligji për Trajtimin e të Miturve në Procedurën Penale (i Malit të Zi) rregullon trajtimin e të miturit si kryerës i veprës penale, fëmijës dhe të miturit si pjesëmarrës në procedurë, e cila bazohet në respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke marrë parasysh interesat më të mira të të miturve; duke marrë parasysh pjekurinë e tyre, nivelin e zhvillimit, aftësive dhe veçorive personale, si dhe peshën e veprës, me qëllim të rehabilitimit dhe riintegrimin e të tyre shoqëror.



Ndaj personit i cili në kohën e kryerjes së veprës së paligjshme (të përcaktuar me ligj si vepër penale), nuk i ka mbushur 14 vjet, nuk mund të merren procedura penale e as nuk mund të zbatohen masa ndëshkuese të përcaktuara me këtë ligj.

I mitur

është personi i cili, në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur 14 vjet, por nuk i ka mbushur 18 vjet;

I mitur i ri

është personi i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur 14 vjet, por nuk i ka mbushur 16 vjet;

I mituri i rritur

është personi i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur 16 vjet, por nuk i ka mbushur 18 vjet;

Person i rritur i ri

është person i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka mbushur 18 vjet por nuk i ka mbushur 21 vjet.

Trajtimin e të miturve të cilët kanë kryer vepra penale e zbaton: ***policia, prokuroria e shtetit, gjykata dhe qendra për punë sociale.***

Kryerja e veprave penale në këtë moshë, në mes 14 dhe 18 vjeç, quhet delikuencë e të miturve dhe konsiderohet si shfaqje e rrezikshme në formën e krimit.

FËMIJA DHE QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Qendrat për punë sociale janë bartësit e punës profesionale në fushën e delikuencës së të miturve. Qendrat për punë sociale janë institucione që merren me probleme të sjelljes antisociale të fëmijëve duke i mbrojtur ata në mënyrë të hapur: përmes mbështetjes së prindërve të tyre në zhvillimin dhe forcimin e marrëdhënieve prindërore si dhe përmes trajtimit dhe risocializimit të të miturve në konflikt me ligjin.

Trajtimi profesional në qendrën për punë sociale mundëson një vlerësim të sjelljes delikuede të të miturve. Ekspertet e qendrës për punë sociale bëjnë vlerësimin e personalitetit të tij, e cila ndryshon në varësi të pjekurisë, njohurive të fituara, përvojave personale, rrethanave nga jeta e tij familjare, shkollimit, marrëdhënieve me prindërit, bashkëmoshataret dhe të tjerët; si dhe nga imazhi që i mituri ka për veten dhe për personalitetin e tij.

Analiza e tillë bën të mundur të kuptohet më mirë se pse i mituri ka hyrë në konflikt me ligjin dhe të përcaktohen masat dhe trajtimi që do të japë rezultatet më të mira, përmes hartimit të planit individual.

Organi kujdestarisë (Qendra) ka për detyrë që prindërve t'iu ofrojë forma adekuate të ndihmës dhe mbështetjes si dhe të marrë masat e duhura në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe interesit më të mirë të fëmijës, në bazë të njohurive dhe informimit të drejtpërdrejtë.

Qendra për Punë Sociale sipas detyrës zyrtare mbron të drejtat e fëmijëve në këtë mënyrë:

- *Paralajmëron prindërit për mangësitë në edukimin e fëmijëve,*
- *Përcakton mbikëqyrje të vazhdueshme mbi ushtrimin e të drejtës prindërore,*
- *Iu privon fëmijën prindërve dhe e dërgon atë në një familje tjetër apo institucion (si një masë e fundit),*
- *Kërkon llogaridhënie për menaxhimin e pasurisë së fëmijës,*
- *Kërkon nga gjykata masa mbrojtëse në pasurinë e prindërve,*
- *Kërkon nga gjykata masën që prindërit të kenë rolin e kujdestarit në aspektin e menaxhimit të pasurisë së fëmijës,*
- *Inicion procedurën për heqjen dhe kthimin e së drejtës prindërore,*
- *Në rastin e fëmijëve pa kujdesin prindëror, merr të gjitha masat që fëmija të mbetet në familje natyrale, vendos kujdestarinë; bën vendosjen në familjen birësuese, institucionin e mbrojtjes sociale, birësimin;*
- *Për qëllime procedurale të divorcit, i jep mendimin gjykatës se kujt t'ia besojë fëmijën; përkujdesët për fëmijën nga lidhja jashtëmartesorë, përcakton vizitat e fëmijës me prindin me të cilin nuk jeton;*
- *Mbron fëmijët që jetojnë në familje të rrezikuara (në aspektin financiar dhe social)*
- *Bën plane individuale për menaxhimin e rasteve për fëmijët në rrezik apo të përjashtuar nga shoqëria.*

Mbrojtja e fëmijëve të cilët shfaqin probleme në sjellje

Në punën me të mitur organi i kujdestarisë ka detyra të veçanta:

- *Nga njoftimi me veprën penale te kryer e deri në vendosjen e sanksioneve penale, punon në njohjen e detajuar të familjes, statusit social dhe financiar të të miturit dhe familjes së tij;*
- *Bën plane individuale përmes menaxhimit të rastit, me propozimin për tejkalimin e gjendjes ekzistuese;*
- *Ballafaqon të miturin me pasojat e veprës penale;*
- *Merr pjesë në vendimmarrje me Prokurorinë, për fillimin e procedurës ose refuzimin e akuzës;*
- *Me gjykatësin për të mitur bashkëpunon gjatë procesit përgatitor, merr pjesë në gjykim dhe jep mendimin për masat edukative;*
- *Organizon, monitoron, zbaton drejtpërdrejtë masën e mbikëqyrjes së përforcuar;*
- *Jep mendimin dhe harton planin individual për të miturit të cilëve iu është dhënë masa edukative në një institucion edukues, institucion korrektues dhe institucion të veçantë për trajtim mjekësor dhe rehabilitim.*
- *Organi i kujdestarisë është i autorizuar ta udhëzojë fëmijën me sjellje antisociale në institucion edukativ me qëllim të risocializimit; mund të lëshojë një vendim për tërheqjen e fëmijëve nga prindërit e tyre dhe ta dërgojë atë në përkujdesjen dhe edukimin e një personi tjetër apo institucioni edukues;*
- *Bashkëpunon gjatë zbatimit të masave edukative me institucionet edukuese dhe korrektuese, me familjen e të miturit; bën përgatitjen për kthimin e të miturit në familje dhe për angazhimin e tij në jetën normale, përmes planit individual të shërbimeve; kujdeset për realizimin e planit të shërbimeve;*
- *Bashkëpunon me të miturin dhe familjen e tij edhe pas përfundimit të masës edukative, deri sa të jetë e nevojshme.*




Qendra për Punë Sociale (organi i kujdestarisë) nuk është palë në gjykim, por është një kontribues i rëndësishëm i procedurës penale.

Vendimi gjyqësor në procedurën ndaj të miturit bazohet në raportin e organit të kujdestarisë. Organi i kujdestarisë është kompetent të jap vlerësimin e personalitetit dhe kushtet e jetës së të miturit, ngase disponon me një ekip profesionistësh të cilët posedojnë njohuritë e duhura në fushën e punës sociale, psikologjisë, pedagogjisë, kriminologjisë.

Raporti është bazë për vendosjen e masave edukative, gjobave, detyrimeve të veçanta, masave të sigurisë, ekzekutimin e sanksioneve dhe vendimin për të pezulluar masat.

Raporti i organit të kujdestarisë është shumë i vlefshëm, por nuk e obligon gjykatësin.



PUNA E POLICISË ME FËMIJËT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Detyra e policisë është të zbulojë kryerësit e të gjitha llojeve të veprave penale të cilat parashihen në dispozitat pozitive të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Malit të Zi.

Të miturit shfaqen edhe si autorë dhe si palë e dëmtuar në procedurë dhe me ata punojnë zyrtarë të policisë të trajnuar posaçërisht për këtë fushë.

Mënyra se si policia e thërret të miturin i cili është në konflikt me ligjin, është kjo:

Policia i dërgon të miturit thirrje me shkrim e cila tregon arsyen e thirrjes se tij. Në thirrje bëhet e ditur edhe pjesëmarrja e obligueshme e prindërve në intervistë (respektivisht e kujdestarit);

Nëse është e nevojshme prania e ndonjë personi tjetër të kualifikuar për të intervistuar një të mitur, me rrugë zyrtare policia njofton punonjësën e qendrës për punë sociale për të marrë pjesë në intervistë, në ambientet e policisë;

Zyrtari i qendrës për punë sociale me njohuritë dhe kompetencat e tij, mund t'i japë të miturit këshilla të dobishme, por edhe të përfaqësojë dhe të mbrojë të drejtat e tij.



Kur i mituri bëhet i dyshuar për veprën penale për të cilën akuzohet, policia është e detyruar ta njoftojë atë me të drejtën e mbrojtjes dhe me të gjitha të drejtat tjera të garantuara me ligj.

Nëse i mituri është zënë në kryerjen e veprës penale dhe është arrestuar, të drejtat e tij janë:

- të jetë i informuar për arsyet e arrestimit,
- të jetë i informuar se nuk ka për detyrë të japë deklaratë,
- për arrestimin e tij të njoftojnë prindërit ose kujdestarët,
- që vet, me ndihmën e prindërve ose kujdestarëve, të zgjedh avokatin mbrojtës,
- që në afatin më të shkurtër të dalë para gjykatësit hetues,
- që pa pengesa të komunikojë me avokatin e vet mbrojtës.

Nëse konstaton se i mituri ka kryer vepër penale, policia paraqet padi penale te prokurori i shtetit.

PROKURORI I SHTETIT PËR TË MITUR

Procedurat penale ndaj personit të miturit mund t'i nisë vetëm prokurori shtetëror për të mitur.

Nëse pas informacionit të mbledhur, prokurori i shtetit konsideron se ndaj të miturit nuk duhet të nisët procedurë penale, ai mund të vendosë të mos filloj procedura penale. Kjo është e mundur për veprat penale të dënueshme me burgim deri në tre vjet ose me gjobë në të holla.

PROCEDURA GJYQËSORE NDAJ TË MITURVE NË KONFLIKT ME LIGJIN

Procedurën gjyqësore ndaj të miturve e drejton gjyqtari për të mitur dhe trupi gjykues për të mitur.

Ndaj të miturit zbatohet një procedurë e veçantë gjyqësore. Pjesëmarrësit në këtë procedurë janë të detyruar të veprojnë me kujdes, duke marrë parasysh zhvillimin mendor, ndjeshmërinë, veçoritë personale dhe privatësisë e të miturit.

Prandaj, me ligj parashihen dispozitat e përgjithshme që zbatohen vetëm për të mitur, të tilla si:

- *Papërgjegjësia e të miturit - kur konstatohet se një i mitur në kohën e kryerjes se veprës penale nuk i ka mbush 14 vjet;*
- *I mituri nuk mund të gjykohet në mungesë;*
- *E drejta për avokatin mbrojtës – i mituri duhet të ketë mbrojtësin e vet në seancën e parë gjyqësore si dhe gjatë gjithë procedurës;*
- *Kur gjykohet i mituri, gjykata gjithmonë e përjashton publikun;*
- *Thirrja e të miturit bëhet përmes përfaqësuesit ligjor;*
- *Fshehtësia e procedurës;*
- *Urgjenca e procedurës;*
- *Paraburgimi caktohet vetëm në raste të jashtëzakonshme;*
- *Në paraburgim i mituri qëndron ndashëm nga të rriturit.*

NDËSHKIMET NDAJ TË MITURVE

Ndaj të miturit që ka kryer vepër penale mund të jepen masa alternative, qëllimi i të cilave është që të mos niset procedurë penale ose të pezullohen hetimet. Zbatimi i këtyre masave ndikon në zhvillimin e përshtatshëm të të miturit dhe në forcimin e përgjegjësisë së tij personale që në të ardhmen të mos kryej vepra penale.

MASAT ALTERNATIVE për të mitur janë: **qortimi** dhe **urdhri për edukim**.

DËNIMET PENALE që mund t'iu shqiptohen të miturve – kryerës të veprave penale, janë: **masat edukative**, **burgimi për të mitur** dhe **masat e sigurisë**.

- *Të miturit të ri (14-16 vjeç) mund t'i shqiptohet vetëm masa edukative;*
- *Të miturit të rritur (16-18 vjeç) mund t'i shqiptohet masa edukative, por në raste të veçanta ai mund të dënohet me burg për të mitur;*
- *I mituri mund të dënohet edhe me masa të sigurisë;*
- *Të miturit nuk mund t'i shqiptohet dënimi me kusht dhe qortimi gjyqësor.*

Qëllimi i shqiptimit të ndëshkimeve penale ndaj të miturve (përmes masave sociale, edukuese e të tjera) është mbrojtja dhe ndihma për të miturit që kanë kryer vepra penale, duke ushtruar mbikëqyrje ndaj tyre; duke bërë aftësimin e tyre profesional dhe zhvillimin e përgjegjësisë personale, për të siguruar edukimin - rehabilitimin dhe zhvillimin e drejtë të tyre, që të aftësohen për rol pozitiv në shoqëri, për të parandaluar rikryerjen e veprave penale.


Burgu për të mitur

Dënimi me burgim për të mitur mund t'i shqiptohet të miturit të rritur (16-18 vjeç) i cili ka kryer veprë penale për të cilën me ligj parashihet dënimi me burgim mbi 5 vjet, kur për shkak të shkallës së lartë të fajësisë së tij, neglizhencës edukative, rrethanave në të cilat është kryer vepra penale si dhe për shkak të peshës së veprës penale, nuk do të ishte e justifikueshme për të dhënë një masë edukative.

Burgimi i të miturve nuk mund të jetë më i shkurtër se 6 muaj dhe më i gjatë se 5 vjet, me përjashtim kur kjo parashihet me Ligj.



Shteti ka një përgjegjësi të qartë për të mbrojtur fëmijët në paraburgim, nga abuzimi dhe lëndimi. Megjithatë, çështja që shoqëria duhet të parashtrijë është - nëse fëmija në përgjithësi duhet të jetë në paraburgim!?





Disa këshilla të vlefshme për të miturit

- ✓ *Dokumente të shumtë ndërkombëtarë garantojnë mbrojtjen e të drejtave të të miturve, prandaj bëhu këmbëngulës;*
- ✓ *Përpiqu që kërkesën për realizimin e të drejtave të tua, ta dërgosh me shkrim dhe në kohën e duhur;*
- ✓ *Kërko vërtetimin e pranimit të kërkesës tënde;*
- ✓ *Bëhu aktiv - informohu si ecën zgjidhja e rastit tënd;*
- ✓ *Përpiqu që të dish sa më shumë për problemin tënd (bisedo me të rriturit, lexo literaturën e duhur, shfrytëzo ndihmën juridike dhe profesionale);*
- ✓ *Respekto afatet e realizimit të të drejtave të tua.*

OJQ Horizonti i Ri
Kodra pn
85360 Ulqin
Telefon: +382 (0)68 300 603
E-mail: horizon@t-com.me
www.ngo-horizonti.org

